REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

RAPORT VJETOR 2012
I AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE

Përmbajtja

Hyrje
Kush jemi ne? 10
Synimet dhe objektivat tona 11
Akterët relevantë 12
Konteksti jonë 13
Si planifikojmë ne? 14
Raporti Vjetor për Vitin 2012 18
Aktivitetet e realizuara 19
- Standardet e Profesionit 20
- Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve 22
- Validimi i kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP 24
- Promovimi I KKK dhe AKK 34
- Bashkëpunimi ndërkombëtar 51

LISTA E SHKURTESAVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim për Arsimin e Lartë
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
IPA	Instrumenti i Ndihmës për Para-Anëtarësim (i UE-së)
KAAP	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korniza Evropiane për Kualifikime
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës & Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
SC	Sigurimi i Cilësisë
UE	Unioni Evropian
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

NJË VIT I SUKSESEVE...



Ragip GJOSHI
Kryetar i KD të AKK

Arsimi dhe Aftësimi Profesional në Kosovë po merr rolin dhe vëmendjen e duhur jo vetëm nga partnerët e përfshirë në të, por edhe nga ofruesit dhe përfituesit e AAP-së. Për t'i dhënë AAP-së rëndësinë e merituar, Këshilli Drejtues i AKK-së sukseshëm ka përmbushur misionin e përcaktuar me dispozita ligjore. Për një vit pune KD i AKK-së ka arritur të bëjë identifikimin e kërkesave të shoqërisë dhe ekonomisë së tregut. Madje, shpreh perceptimin e opinionit se vizioni i AKK-së për krijimin e një sistemi cilësor të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar është përmbushur. KD në angazhimet e veta ka arritur t'i fokusojë në procesin e akreditimit e validimit të ofrueseve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional; ka arritur të zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, ka bërë rishikime periodike të vlerësimit dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve, gjithnjë në mbështetje të Ligjit për Kualifikime Kombëtare. Kështu, jemi të bindur se është ndikuar dukshëm në ngritjen e cilësisë së sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të lartë, si një nga prioritetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Mirëpo, për vitet në vijim , për Kosovën

mbetet sfidë të krijojë një fuqi punëtore të aftë, fleksibile që të mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal dhe global. KD gjithnjë i mbështetur në hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare, duke zhvilluar politikat e MAShT, rekomandimet e KAAP, OEK, MPMS, etj. Asnjëherë nuk ka munguar edhe mbështetja e drejtëpërdrejtë e ministrit të Arsimit për të pasur Standardet e Profesionit, për rregullimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve , në procesin e validimit të kualifikimeve në KKK dhe akreditimit të ofruesve të AAP, si dhe në promovimiin e KKK dhe AKK, në organizimin e konferencave, punëtorive informuese për KKK dhe në bashkëpunimin e mirëfilltë ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2012 në takimet e Këshillit Drejtues të AKK është realizuar Plani i Punës dhe synimet kryesore të AKK-së. Në këtë periudhë vlenë të veçohen aktivitetet, si: popullimi i KKK me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të Validimit; akreditimin e ofruesve publikë dhe privatë të arsimit dhe aftësimit profesional në të gjithë vendin; promovimi i KKK me organizimin e aktiviteteve që krijon vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së; pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktivitete ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së.

KD ka ndihmuar punën e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) si organ i pavarur. Gjatë këtij viti ka qenë shumë i përkushtuar për realizimin e përgjegjësive për mirëmbajtjen e Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional(AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të mësuarit, që synim kishin sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP. Po theksoj edhe zhvillimin dhe verifikimin e standardeve të profesionit dhe verifikimit të dymbëdhjetë standardeve të profesionit, etj. Përmes veprimtarisë së kësaj, AKK është synuar t'i jepet AAP-së një zhvillim i mëtejshëm në vendin tonë, kryesisht në drejtim të institucionalizimit dhe rritjes së cilësisë së arsimit dhe formimit të ofruar. AKK është përballur me problemet që has vetë arsimi profesional në Kosovë, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e dobëta midis AAP-së dhe tregut të punës apo edhe mungesës efektive të partneritetit në këtë fushë. AKK bëri çdo përpjekje që t'i kapërcejë këto barriera dhe të sigurojë . AKK ka pasur dhe do të ketë partnerë seriozë në përmbushjen e objektivave të saj dhe kështu jemi të ndërgjegjshëm se zhvillimi i AAP-së në Kosovë po bëhet në përputhje me standardet e kërkuara evropiane.

Po përmbyll këtë fjalë me konkluzionin se rezultatet e shënuara janë fryt i punës së KD, por edhe i një përgjegjësie të madhe dhe ndihmës së pakursyer profesionale të të gjithë stafit të AKK-së. Ndërkaq, krejt në fund në emër të KD, uroj që misioni i marrë përsipër, me një transparencë të plotë në angazhim, të arrijë nivelin evropian.

KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE - NJË MUNDËSI MË SHUMË PËR TY



Teuta Danuza

Drejtore e AKK

Ky vit u karakterizua me sukses nga fillimi! Suksesi i AKK në vitin 2012 mund të matet me një kulturë të re që mbështet sistemin e kualifikimeve në Kosovë. Sot gjithandej flitet për nivelet e kualifikimeve, akreditimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve dhe institucioneve, një numër në rritje i individëve janë duke kërkuar kualifikime të njohura nga AKK , derisa partnerët socialë kanë gjetur në AKK një partner të shkëlqyer për hartimin dhe përgatitjen e standardeve të profesionit.

Ky raport është dëshmi e udhëheqjes kreative, angazhimit serioz dhe punë së vështirë. Është qartë nga cilësia dhe numri i aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara se AKK është duke ndërtuar një reputacion të standardit të lartë, konsistencës dhe të shërbimit në komunitetin tonë. Lista e ngjarjeve të organizuara gjatë 2012 është mbresëlënëse sidomos kur merren parasysh burimet e kufizuara njerëzore që AKK posedon. Sinergjia brenda këtij ekipi të vogël, por entuziast, ka dhënë rezultate të rëndësishme, të cilat janë të evidentuara nga reputacioni dhe kredibiliteti i AKK-së brenda dhe jashtë vendit.

Arritjet më ambicioze në 2012 kanë qenë; miratimi i kualifikimeve të para në nivelet 2,3 dhe 4 në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe akreditimi i institucioneve që vlerësojnë dhe lëshojnë këto kualifikime. Cilësia e këtyre kualifikime është në përputhje me standardet evropiane dhe

këto kualifikime përmbushin nevojat e tregut të punës dhe shoqërisë në Kosovë. AKK gjatë 2012 gjithashtu ka përgatitur infrastrukturën ligjore për njohjen zyrtare të të nxënit të arritur në kontekst joformal dhe informal në mënyrë që t'ju mundësojë individëve të arrijnë kualifikimin në bazë të asaj që ata janë të aftë për të bërë.
AKK gjithashtu ka mbajtur me sukses, në bazë të rregullt, një sërë takimesh dhe diskutime me të gjitha palët e interesit, duke marrë në konsideratë njohuri të reja, këndvështrime të ndryshme dhe duke ofruar një pronësi të gjerë të proceseve që kanë të bëjnë me mekanizmat e sigurimit të cilësisë, aprovimit të kualifikimeve dhe akreditimit të ofruesve të AAP-së.

Përmes pjesëmarrjes së saj aktive në ngjarjet vendore, rajonale dhe evropiane, AKK ka krijuar një rrjeti të shkëlqyer të ekspertëve vendas dhe të huaj në fushën e kualifikimeve dhe sigurimit të cilësisë.

Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare të Kosovës sukses ka shënuar gjatë vitit 2012, me rastin e anëtarësimit të AKK si anëtare vëzhguese e Rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP – EQAVET. Anëtarësia në EQAVET është hap para drejt realizimit të synimeve të AKK-së; ngritjen e cilësisë në arsimin dhe trajnimin në Kosovë në përputhje me standardet evropiane.
Viti para nesh është po aq sfidues! Por, unë jam e bindur se tre vitet e kaluara kanë ndërtuar kapacitete për të tejkaluar këto sfida. AKK do të vazhdojë në misionin e saj për të ndihmuar të gjithë ofruesit e trajnimit dhe nxënësit për të lëvizur drejt niveleve të përsosmërisë në arsim dhe trajnim dhe të mbështesë zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës, duke rritur cilësinë në AAP, duke u mundësuar nxënësve që të pajisen me shkathësitë e duhura për tregun e punës dhe më e rëndësishmja për të bërë të mësuarit gjatë gjithë jetës një mjet për të mbështetur punësimin e tyre.

Për këto arritje, ne i jemi shumë mirënjohës Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Fondacionit Evropian për Trajnim dhe Këshillit Britanik për angazhimin dhe zotimin e vazhdueshëm për të përkrahë AKK-në drejt përmbushjes së misionit të saj që; të zhvillojë veten si një institucion me një drejtim, atë të ngriitjes së cilësisë në arsimin dhe trajnimin në Kosovë, gjithnjë duke u bazuar në filozofinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Unë do të doja të zgjeroj këtë falënderim për të gjithë partnerët dhe donatorët e tjerë që mbështesin punën e AKK!
Një falënderim i veçantë vlen edhe për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, për mbështetjen e iniciativave tona dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK-së dhe KKK-së.
Gjithashtu, do të falënderoja Këshillin Drejtues dhe stafin ekzekutiv të AKK-së për kontributin madhor në zhvillimin e institucionit, si dhe performancën gjatë vitit 2011-12!

Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare të Kosovës sukses ka shënuar gjatë vitit 2012, me rastin e anëtarësimit të AKK si anëtare vëzhguese e Rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP – EQAVET.

AUTORITETI KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE

KËSHILLI DREJTUES

Ragip Gjoshi	Kryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së (MAShT)
Anton Gojani	Nënkryetar i Këshillit Drejtues te AKK-se (Don Bosko)
Agim Shahini	Anëtar -Aleanca Kosovare e Biznesit
Arbëresha Turjaka	Anëtare- Ministria e Shëndetësisë
Avdi Smajlaj	Anëtar -Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Bedri Xhafa	Anëtar - Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit në Kosovë
Besim Mustafa	Anëtar- Oda Ekonomike
Edita Krasniqi	Anëtare -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ferdije Zhushi	Anëtare - Agjencia e Akreditimit të Kosovës
Ilir Ibrahimi	Anëtar- Universiteti Amerikan i Kosovës
Mehreme Llumnica	Anëtare -Handikos
Menderes Ibra	Anëtar -Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Tahir Arbneshi	Anëtar -Universiteti i Prishtinës

STAFI EKZEKUTIV:

Teuta Danuza	Drejtore
Avni Gashi	Ekspert për sigurim të cilësisë
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
Kaltrina Mulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Donjeta Nimani	Asistente Administrative



Ligji për Kualifikime Kombëtare

KUSH JEMI NE?

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është organ i pavarur publik i themeluar në dhjetor të vitit 2009, në bazë të Ligjit për Kualifikime Kombëtare (Ligji 03/L-060).

AKK ka përgjegjësi të përgjithshme për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK); në përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në KKK; harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK); caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP); përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK; lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të mësuarit, si dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP.

AKK ka Këshillin drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, që përfaqësohet nga ministritë, organizatat e partnerëve socialë dhe universitetet publike.

AKK ka stafin ekzekutiv prej gjashtë (6) anëtarëve: drejtoren, zyrtarin për standarde, zyrtarin për kualifikimeve, dy zyrtarë për sigurim të cilësisë dhe asistentën administrative.

SYNIMET DHE OBJEKTIVAT TONA

Misioni i AKK-së është të mbikëqyrë dhe zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit në gjitha nivelet dhe në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.
Vizioni i AKK-së është krijimi i një sistemi cilësor të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për të arritur këtë AKK do të:

- aprovojë kualifikimet që do të përfshihen në nivelet e caktuara të Kornizës dhe riaprovojë ato sipas nevojës;
- akreditojë, rregullojë dhe monitorojë ofruesit e Arsimit dhe Aftësimit Profesional;
- zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që çojnë te dhënia e kualifikimeve në KKK;
- mirëmbajë bazën e të dhënave dhe evidencave të verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe të certifikatave dhe diplomave të dhëna;
- bëjë rishikime periodike të vlerësimit dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
- këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, mbi çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
- certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në Kornizë miratohen me vulë të Autoritetit dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa e AKK;

AKTERËT RELEVANTË

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë, AKK krijon dhe mirëmban raporte bashkëpunuese dhe procese konsultative me të gjithë akterët relevantë të KKK, përfshirë:

- Nxënësin/kandidatin
- Mësimdhënësit dhe trajnerët
- Menaxherët në shkolla, kolegje universitare dhe universitete
- Koordinatorët për sigurimin e cilësisë tek ofruesit
- Punëdhënësit dhe punëtorët
- Ofruesit publikë dhe privatë të aftësimit profesional
- Sindikata dhe shoqata profesionale
- Qeverinë në nivel qendror dhe lokal
- Agjenci dhe Këshille në nivel kombëtarë



KONTEKSTI JONË

Sistemi i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) dhe Arsimit të lartë në Kosovë, duhet t'i plotësojnë në mënyrë adekuate nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë së sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të lartë është prioritet i Qeverisë së Kosovës në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP dhe AL të jenë në nivel të kënaqshëm. Për momentin, për Kosovën ende mbetet sfidë të krijojë një fuqi punëtore të aftë, fleksibile që të mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal dhe global.

Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për t'u aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë ky është ndikimi i drejtpërdrejtë i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë kosovare. Kjo Kornizë me kriteret e saj parasheh që fillimisht institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifikim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi është i kërkuar në tregun e punës. Dëshmi mund të jenë hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si: MAShT, KAAP, OEK, MPMS, etj. Gjithashtu, sipas KKK, kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde profesionale, që është baza e kualifikimit. Këto standarde profesionale duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Pra, punëdhënësi merr pjesë aktive në këtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat duhet punëtori t'i demonstrojë për kualifikimin në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK që duhet të plotësohen nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime.

AKK ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, që do t'i ndihmojnë institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional të përmbushin këto kritere dhe të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.



Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

SI PLANIFIKOJMË NE?



Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

AKK zhvillon politikat dhe strategjitë për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Nr.03/L-060).
Bazuar në objektivat strategjike të AKK-së, ne zhvillojmë Planin e Punës së AKK-së, duke përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet për 12 muajt e ardhshëm. Stafi ekzekutiv i AKK-së është përgjegjës për zbatimin e zotimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Punës, ndërsa në çdo takim të KD të AKK-së rishikohet progresi i aktiviteteve sipas Planit të Punës.

AKK paraqet raportin mbi progresin e aktiviteteve të veta te MAShT, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë relevante, çdo gjashtë muaj, ndërsa raportin vjetor e prezenton te Qeveria e Kosovës.

Gjatë vitit 2012, janë mbajtur 8 takime të Këshillit Drejtues të AKK. Takimet e Këshillit janë mbajtur më 26 janar, 2 mars, 13 prill, 18 maj dhe në 19 tetor dhe 15 dhjetor. Takimet u ndoqen nga anëtarët, përfshirë edhe kryetarin e Këshillit Drejtues, z. Gjoshi, si dhe drejtoren e AKK, znj.Danuza.



Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2012

KD i AKK në fillim të vitit miratoi Planin e Punës për vitin 2012.
Synimet kryesore të AKK-së për vitin 2012 janë si më poshtë:

1. Popullimi i KKK me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të validimit;

2. Akreditimin e ofruesve publikë dhe privatë të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në të gjithë vendin;

3. Të kontribuojë në sigurimin e cilësisë së programeve dhe aktiviteteve në shkollat profesionale të MAShT-it;

4. Strategjia ndërvepruese e komunikimit që siguron efikasitet më të madh në procesin e validimit, akreditimit dhe sigurimit të cilësisë;

5. Konsultim të gjerë me akterët relevantë të KKK;

6. Promovimi i KKK me organizimin e aktiviteteve që krijojnë vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së;

7. Pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktivitete ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së;

Plani i Punës për vitin 2012 i detajizuar mund të shkarkohet nga ueb -faqja e AKK-së

www.akk-ks.net


NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2012

Ky raport është një përmbledhje e të gjitha aktivitetet dhe objektivave të realizuara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2012, në përputhje me Planin e Veprimit për vitin 2012, në përputhje dhe në harmoni me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, si dhe sipas Planit Vjetor të aktiviteteve, të hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së. Në këtë raport do të paraqiten, të ndarë në sektorë, të gjitha aktivitetet e realizuara për zhvillimin dhe implementimin e KKK, gjatë këtij viti.

AKTIVITETET E REALIZUARA



Pamje nga punëtoritë e AAP-së

STANDARDET E PROFESIONIT

AKK pas procesit të vitit të kaluar, ku u trajnuan 11 ekipe për zhvillimin e standardeve të profesionit, përgatitjes së dokumentacionit përkatës për zhvillimin dhe verifikimin e standardeve të profesionit dhe verifikimit të dymbëdhjetë (12) standardeve të profesionit, edhe këtë vit ka vazhduar me aktivitetet e saj për verifikimin dhe validimin e standardeve të profesionit në disa sektorë. Procesi i verifikimit të standardeve të profesionit nuk ka filluar dhe zhvilluar sipas planit të punës së AKK, pasi që këto standarde janë sjellë shumë vonë për verifikim nga KAAP. Standardet e profileve të ekonomisë, turizmit dhe tregtisë janë zhvilluar në mbështetje të Projektit KSV/015 Project "Mbështetje e reformës së Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Kosovë"- financuar nga "Dukata e Madhe e Luksemburgut" në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës dhe MAShT, ndërsa ato për profilin Automekanik nga Oda ekonomike e Dortmundit. Standardet të cilat janë përcjellë nga KAAP për verifikim dhe validim në AKK janë:



-Makineri
- •Automekanik

-Ekonomi
- •Nëpunës i shërbimeve bankare
- •Nëpunës financiar
- •Nëpunës i marketingut
- •Nëpunës i burimeve njerëzore
- •Nëpunës për administrim zyre dhe menaxhim
- •Nëpunës industrial

-Tregti
- •Shitës me pakicë
- •Shitës me shumicë
- •Shitje dhe shërbimi i klientit
- •Nëpunës i eksportit dhe importit

-Turizëm
- •Planifikim dhe menaxhim i ngjarjeve
- •Nëpunës në menaxhim turistik
- •Planifikim udhëtimi dhe shërbime informative turistike

Duhet theksuar se ky proces është i vazhdueshëm. Edhe përkundër vonesave është shënuar progres në fushën e zhvillimit dhe verifikimit të standardeve të profesionit.

RREGULLIMI I KORNIZËS KOMBËTARE TË KUALIFIKIMEVE

KKK është e rregulluar përmes mekanizmave që synojnë të sigurojnë përputhje me aranzhimet dhe kërkesat e përcaktuara për sistemin e kualifikimeve dhe për të siguruar se sistemi ofron kualifikime me cilësi të pranueshme. Tashmë janë rregulluar të gjithë mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave:

- Validimin dhe aprovimin e kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimin e institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Sigurimin e cilësisë së institucioneve të akredituara dhe ofrimin e kualifikimeve të validuara;
- Sistemi i kredive;
- Njohja e mësimit paraprak.



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK, ka mbajtur mbi 60 takime në zyrat e veta, që kryesisht kishin të bëjnë me:

- Rishikimin dhe adaptimin e planit të punës;
- Përgatitjen për procesin e Validimit dhe Akreditimit;
- Përgatitjen e certifikatave dhe vendimeve për akreditim;
- Hartimin e konkurseve për panelë të ekspertëve të jashtëm dhe botimit të tyre në gazetat ditore;
- Përgatitjen e listës së ngushtë, intervistimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm;
- Përgatitjen e planeve për aktivitetet e SC të mbështetura nga Këshilli Britanik;
- Organizimin e konferencave për shtyp;
- Përgatitjen e termave të referencës për ekspertin e jashtëm të financuar nga ETF për sigurimin e cilësisë;
- Planifikimi dhe organizimi i punëtorive për sigurim të cilësisë;
- Mbështetja për takimet e Këshillit Drejtues të AAK;
- Takime të rregullta me zyrtarët e MAShT;
- Organizimin e vizitave në terren dhe për panelet e ekspertëve të jashtëm për validim dhe akreditimin, etj.

Gjatë vitit 2012, AKK ka organizuar tri (3) runde të procesit të validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve ofruese dhe vlerësuese për kualifikime të zhvilluara sipas standardeve të verifikuara kombëtare apo ndërkombëtare.

Shumë shpejtë pritet që të fillojë edhe rundi i katërt i procesit të akreditimit të institucioneve që ofrojnë mësimin e gjuhëve të huaja.

Ekspertët e AKK kanë marrë pjesë aktive me rastin e rishikimit të ligjeve të AAP Nr. 2006/24 dhe Ligjit për Arsimin e të Rriturve, harmonizimin e tyre me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare 2008_03-L-060, si dhe për hartimin dhe nxjerrjen e aktit nënligjor të paraparë sipas Ligjit të arsimit parauniversitar Nr. 04/L-032, lidhur me ofrimin e shërbimeve private arsimore dhe aftësuese apo lidhur me mbështetjen e shërbimeve të tilla nga ana e organizatave apo operatorëve qeveritarë, gjithsej me shtatë (7) takime dhe një konferencë (2) dy ditore në Shqipëri.

Gjatë muajit nëntor 2012, grupi punues i AKK, i përbërë nga ekspertë të fushës nga të gjitha palët me interes, në kuadër të punëtorisë treditore, ka hartuar draft Udhëzimin Administrativ për Njohjen e Mësimit Paraprak, bazuar në Ligjin mbi KKK.





VALIDIMI I KUALIFIKIMEVE NË KKK DHE AKREDITIMI I OFRUESVE TË AAP

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka planifikuar, organizuar dhe ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me Validimin dhe Akreditimin e ofruesve të AAP, përfshirë edhe vizitat e paneleve të ekspertëve në terren. Për këtë proces janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm të fushave përkatëse në njëmbëdhjete (11) panele.



Në fillim të procesit për secilin rund është mbajtur takim me të gjithë ekspertët e paneleve, të cilat takime kishin karakter informues në lidhje me procesin e Validimit dhe Akreditimit të institucioneve aplikuese.

Procedurat dhe vijueshmëria e punës lidhur me të gjitha grupet e panelit ishte si në vijim:

- Takimi për shqyrtimin e aplikacioneve
- Vizita në terren
- Përpilimi i raportit final të vlerësimit për Validim të kualifikimit dhe Akreditim të ofruesve
- Takim për shqyrtimin e aplikacioneve

Pas takimit të parë informues rreth procedurave të validimit dhe akreditimit, zakonisht janë mbajtur edhe takimet e paneleve për shqyrtimin e materialeve dhe dokumenteve të institucioneve aplikuese.

Panelet së bashku me ekspertët përkatës të profilit, verifikuan dhe kontrolluan aplikacionet për validim dhe akreditim, ku gjatë kësaj faze janë identifikuar nevojat dhe çështjet, të cilat duhej ngritur gjatë takimeve që mbaheshin me institucionin aplikues.
Në këtë fazë u përgatiten edhe pyetjet dhe çështjet që do t'i nënshtrohet ofruesit, të bazuara në aplikacionet dhe dëshmitë tjera. Gjatë këtyre takimeve janë verifikuar edhe dokumentacionet dhe dëshmitë e ofruara apo të kërkuara nga anëtarët e paneleve: Raportet e vetëvlerësimit, literatura, stafi e CV-të dhe dëshmitë tjera relevante për procesin.



Pamje nga vizita në QSE "Don Bosko"

VIZITA NË TERREN

Gjatë vizitave në terren panelet u pritën nga menaxherët e institucioneve, zyrtarët për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënësit/trajnerët e profileve përkatëse, nxënësit ose pjesëmarrësit e trajnimeve dhe janë vizituar disa punëtori dhe institucione në të cilat këta kandidatë janë duke e kryer pjesën praktike.

Fillimisht gjatë vizitës u zbatua verifikimi i gjendjes, dëshmive dhe materialeve sipas Aplikacionit për Validim të kualifikimeve. Sipas procedurave për validimin e kualifikimit u verifikuan këto pika:

-Modulet
-Struktura e kualifikimit
-Numri i kredive
-Qëllimi dhe përmbajta e kualifikimit/modulit
-Niveli i kualifikimit/modulit në KKK
-Pjesa teorike dhe praktike
-Standardet profesionale
-Njohja e mësimit paraprak
-Mënyra dhe kriteret e vlerësimit
-Literatura



Pamje nga vizita e bërë në QAKP "Gjon Nikollë Kazazi"

Po ashtu, gjatë vizitës edhe sipas Aplikacionit për Akreditimin e ofruesve u bë verifikimi i gjendjes, dëshmive, infrastrukturës dhe materialeve duke përfshire këto pika:

-Pajisjet dhe mjetet për praktikë
-Kabinetet dhe punëtoritë
-Gjendja financiare
-Stafi dhe menaxhmenti
-Kriteret dhe politikat për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta
-Qasje të barabartë për kandidatë
-Siguria dhe shëndeti
-Certifikimi
-Databaza

Gjatë këtij procesi u vlerësua përshtatshmëria e objektit me kualifikimin e ofruar, infrastruktura për kandidatë me nevoja të veçanta, siguria dhe çështje tjera me interes.



Pamje nga vizita në QSE "Don Bosko"



Pamje nga vizita në QRAP Prizren

Pamje nga vizita në QT "KEK"



Pamje nga vizita në QT "KEK"



PËRPILIMI I RAPORTIT FINAL TË VLERËSIMIT PËR VALIDIM DHE AKREDITIM

Në kuadër të këtij procesi, panelet përkatëse përpiluan draft- raportet për validimin dhe akreditimin për kualifikimet përkatëse të institucioneve aplikuese. Raportet u krijuan duke u bazuar në dokumentet, materiale dhe dëshmitë e ofruara përfshirë edhe vizitat në institucione dhe dëshmitë shtesë dhe informatat kthyese nga institucionet përkatëse. Raportet janë pasqyrim i gjendjes te ofruesit dhe vlerësimi i panelit u bazua konform kritereve të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji për Kualifikime Kombëtare. Të gjitha draft- raportet janë kthyer në institucione për ta bërë vlerësimin/ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar sipas procedurave të UA.

Pas kësaj procedure raportet finale i janë dërguar Këshillit Drejtues të AKK me rekomandime për aprovim ose mos aprovim.

Duhet theksuar se i tërë ky proces gjatë vitit 2012, pa marrë parasysh vështirësitë dhe numrit të kufizuar të stafit që ka AKK, ka rrjedhë jashtëzakonisht mirë dhe në frymën e një bashkëpunimi shumë të ngushtë me institucionet aplikuese dhe palët me interes të përfshira në proces.



Tri rundet e procesit të Validimit të kualifikimeve dhe akreditimit të institucioneve të AAP me gjithsej njëzet e tetë 28 vizita në terren për shtatë 7 kualifikime, sipas periudhave në vijim:

- Prill-Maj, janë zhvilluar vizita në terren të ekspertëve të procesit të Validimit dhe Akreditimit për profilet Metalpunues/Saldim dhe Asistent Administrativ në QSE Don Bosko në Prishtinë, QRAP në Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, Ferizaj dhe QT të KEK.

- Qershor-Korrik, janë zhvilluar vizita në terren të ekspertëve të procesit të Validimit dhe Akreditimit për profilet Instalues i ujit dhe kanalizimit, Instalues i ngrohjes qendrore, Instalues elektrik dhe Asistent Administrativ në QSE "Don Bosko" në Prishtinë, QRAP në Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovice dhe Gjilan, QT Diakonie në Mitrovicë, QAKP "Gjon Nikollë Kazazi" në Gjakovë, QT ZH të PTK, QAP "Dituria" Prizren dhe QT të KEK.

- Tetor-Nëntor, janë zhvilluar vizita në terren të ekspertëve të procesit të Validimit dhe Akreditimit për fushën e Teknologjisë Informative dhe Furrtarisë në QSE "Don Bosko" në Prishtinë, QRAP në Prizren, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan, Prishtinë QAKP "Gjon Nikollë Kazazi" në Gjakovë, QTZH të PTK, APPK dhe QT të KEK.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, nga procesi i lartëpërmendur ka rezultuar me validimin dhe regjistrimin e këtyre kualifikimeve në KKK:

- Asistent Administrativ (niveli III dhe IV në KKK);
- Saldues (niveli III dhe IV në KKK);
- Instalues Elektrik (niveli III në KKK);
- Instalues i ngrohjes qendrore (niveli III në KKK);
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit (niveli III në KKK)
- Teknologji informative dhe komunikim (niveli II, III dhe IV në KKK)



Pamje nga arkivi i AKK-së

Certifikatat e lëshuara nga AKK për ofruesit e akreditуar



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka akreditуar institucionet e AAP-së për të ofruar kualifikimet e regjistruara në KKK me afat kohor prej një deri tri vite, pa kushte ose me kushte të përcaktuara, si në vijim:

QRAP Prizren

- Saldim, niveli i KKK-së (III)
- Asistent Administrativ, niveli i KKK-së (III)
- Teknologji Informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (II)

QRAP Pejë

- Saldim, niveli i KKK-së (III)
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit (III)
- Instalues elektrik, niveli i KKK-së (III)

QRAP Mitrovicë;

- Saldim, niveli i KKK-së (III)
- Teknologji Informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (II)

QRAP Gjilan

- Saldim, niveli i KKK-së (III)

QRAP Gjakovë

- Saldim, niveli i KKK-së (III)
- Asistent administrativ, niveli i KKK-së (III)

QRAP Ferizaj

- Saldim, niveli i KKK-së (III)
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit (III)
- Instalues elektrik, niveli i KKK-së (III)
- Teknologji informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (II)

QAKP "Gjon Nikollë Kazazi" Gjakovë

- Asistent administrativ, niveli i KKK-së (IV)
- Teknologji informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (IV)

QES "Don Bosco" Prishtinë

- Saldim, niveli i KKK-së (III)
- Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit (III)
- Instalues elektrik, niveli i KKK-së (III)
- Asistent administrativ, niveli i KKK-së (IV)
- Teknologji informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (IV-për shkollë)
- Teknologji informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (II-për QT)

QT KEK

- Saldim, niveli i KKK-së (IV)
- Metalpunues (tornim, frezim, shpim dhe prerje), niveli i KKK-së (III)
- Instalues elektrik, niveli i KKK-së (IV)
- Teknologji informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (II)

QTZHK PTK Prishtinë

- Asistent administrativ, niveli i KKK-së (III)

Agjencioni i Përkrahjes së Punësimit i Kosovës (APPK)

- Teknologji informative dhe komunikim, niveli i KKK-së (II)

PROMOVIMI I KKK DHE AKK

Pamje nga një punëtori e mbajtur për KKK dhe rolin e AKK-së

AKK ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të gjitha palët e interesit të informuar mirë, duke përfshirë edhe publikun e gjerë. Kjo është bërë përmes aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme si në vijim:

-Krijimi i takimeve me palët e interesit (ofruesve publikë, privatë dhe në përgjithësi të ofruesve të AAP) në baza të rregullta;
-Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat;
-Organizimin e ceremonisë për shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i Validimit dhe Akreditimit;
-Pjesëmarrje në konferenca lokale, rajonale dhe vizita studimore;
-Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara;
-Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar;
-Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes;
-Publikimin dhe shpërndarjen e publikimeve të ndryshme, etj.



Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) gjatë muajit shkurt 2012 ka organizuar pesë (5) punëtori rajonale për sigurim të cilësisë në Ferizaj, Gjilan, Prizren, Prishtinë, Pejë, nën përkrahjen e ekspertëve të Këshillit Britanik, z. Adam Vernen, znj. Donika Berisha. Në këto punëtori kanë marrë pjesë zyrtarët e MAShT për AAP, koordinatorët për sigurim të cilësisë dhe inspektorët rajonalë në secilin rajon. Çështjet e diskutuara në këto punëtori kishin të bëjnë me raportet e vetëvlerësimit të ofruesve të AAP për rajonet përkatëse, gjendjen e përshkruar në këto raporte, planet e tyre të përmirësimit, planet zhvillimore, si dhe janë dhënë këshilla dhe sugjerime për të gjitha palët me interes në AAP në rajonet përkatëse, që do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë në sistemin e AAP.



AKK me mbështetjen e Fondacionit Evropian për Trajnime – ETF ka planifikuar dhe organizuar një serë takimesh dhe punëtorish për Sigurimin e Cilësisë për institucionet e AAP me theks të veçantë për shkollat, që nuk kanë hartuar raportet e vetë-vlerësimit ose që kanë hartuar raporte në të cilat janë vërejtur mangësi të theksuara.
Janë organizuar tetë (8) takime dhe dy (2) punëtori dyditore gjatë periudhës maj, qershor, tetor nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me ndihmën e ekspertit Ian Greer, ku janë diskutuar sfidat dhe vështirësitë për zbatimin e sigurimit të cilësisë në këto institucione; është bërë identifikimi i mangësive nga raportet e vetëvlerësimit dhe janë dhënë këshilla për hapat e mëtutjeshëm për përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Përmirësimit.

Për ndarjen e certifikatave për ofruesit nga procesi i Akreditimit dhe Validimit, në procesin e parë, gjatë muajit qershor 2012, është organizuar një ceremoni të cilën e ka nderuar me pjesëmarrje ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prof. Dr. Ramë Buja, pastaj Këshilli Drejtues i AKK, ofruesit e AAP, ministritë relevante dhe media elektronike dhe të shkruara.



Pamje nga punëtoritë e





Ceremonia e shpërndarjes së certifikatave të ofruesve/institucioneve të akredituara nga AKK

Ceremonia e shpërndarjes së certifikatave të ofruesve/institucioneve të akredituara nga AKK

Prej 12-15 nëntor 2012, AKK ka organizuar trajnim 5 ditor për institucionet që ofrojnë kurse për gjuhë të huaja, për t'i njoftuar këto institucione lidhur me procesin, kriteret dhe procedurat që duhet të ndiqen për akreditim, rolin e AKK në këtë proces dhe për zbatimin e KKK.

Nga 19-20 nëntor 2012, AAK ka organizuar punëtorinë treditore në Shqipëri me pjesëmarrjen e anëtarëve të KD të AKK, Këshillit të AAP, MAShT, ekspertëve të ofruesve dhe vlerësuese të AAP, institucioneve dhe palëve tjera me interes. Në këtë punëtori janë diskutuar sfidat dhe vështirësitë që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë, hartimin e raporteve të vetëvlerësimit, të kuptuarit më të mirë të principeve të cilësisë nga Korniza për Sigurim të Cilësisë dhe janë nxjerrë përfundime të vlefshme për të përmirësuar tërë procesin e Validimit dhe Akreditimit të kualifikimeve.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority





Në kuadër të zbatimit të strategjisë për promovimin e KKK, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, në dhjetor të vitit 2012, do të vazhdojë fushatën e saj promovuese në TV nacionale dhe lokale, si dhe në mjetet e shtypit ditor dhe atij periodik.



Pamje nga punëtoritë e organizuar nga AKK



Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë shumë i angazhuar në gjysmën e parë të vitit 2012 në dizajnimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të prodhuara më parë së bashku me projektin BE Kosvet V. Dokumentet kryesore janë publikuar në formë të shtypur, me dizajn dhe shenjë adekuate, në tri gjuhët shqipe, angleze dhe serbe dhe u janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP dhe institucioneve tjera që ofrojnë trajnime, arsim dhe aftësim, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.

Po ashtu, AKK këtë vit ka udhëhequr procesin e dizajnimit dhe përgatitjes teknike të raportit vjetor të AKK për 2011, publikimin e dokumenteve për sigurim të cilësisë, kualifikimeve dhe standardeve dhe të dizajnimit dhe mirëmbajtjes së ueb faqes së AKK.

Këto publikime janë grupuar si më poshtë:

1.Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

Ky është një dokument i rëndësishëm, i cili përcakton në detaje kontekstin e politikave dhe kërkesave kryesore të sistemit profesional të kualifikimeve.



2. Zhvillimi i standardeve të profesionit dhe kualifikimeve profesionale

Kjo është një pako me udhëzime praktike dhe materiale përkatëse burimore që iu dedikohet atyre që merren me hartimin dhe zhvillimin e kualifikimeve profesionale për përfshirje në KKK. Kjo përbëhet nga një dosje ose kuti, ku përfshihen shtesat mbi zhvillimin dhe verifikimin e standardeve të profesionit, përcaktimin e rezultateve të mësimit dhe moduleve, zhvillimin e kualifikimeve modulare të AAP-së, vlerësimin e kualifikimeve modulare të AAP-së, verifikimin e brendshëm të vlerësimeve, regjistrimin dhe certifikimin e kandidatëve, qasjen për persona me aftësi të kufizuar ose me nevoja të veçanta.



3. Sigurimi i cilësisë në institucionet e AAP-së: Një udhëzues praktik për implementim

Dokumenti përmban udhëzime praktike dhe materiale burimore përkatëse të synuara për ofruesit e AAP-së për të mbështetur implementimin e procedurave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, duke përfshirë instrumentin e vetëvlerësimit dhe listat kontrolluese të planifikimit zhvillimor dhe instrumentet për përgatitje për inspektime.





Gjithashtu edhe një numër i publikimeve të tjera si më poshtë:

- Udhëzuesi për zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi të cilësisë për AAP
- Udhëzuesi për plotësimin e aplikacioneve për verifikim dhe akreditim
- Raporti i AKK-së 2011 dhe Plani i Punës për 2012
- Posterat e vendosur në ndërtesat publike dhe në objektet e institucioneve të arsimit dhe të aftësimit, si dhe punëdhënësve
- Kalendari me logo dhe informata të kontaktit të AKK.

Dukumentet e publikuara, të cilat u janë shpërndarë të gjitha palëve me interes dhe institucioneve partnere, janë:

1. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
2. Udhëzuesi i sigurimit të cilësisë për institucionet e akredituara post-sekondare të AAP
3. Zhvillimi dhe verifikimi i standardeve të profesionit
4. Përcaktimi i rezultateve të mësimit dhe moduleve
5. Zhvillimi i kualifikimeve modulare të AAP-së
6. Vlerësimi i kualifikimeve modulare të AAP-së
7. Verifikimi i brendshëm i kualifikimeve të AAP-së
8. Dokumenti për personat me nevoja të veçanta në fushën e AAP-së
9. Sigurimi i cilësisë në institucionet e AAP-së: Udhëzues për zbatim praktik
10. Udhëzues për zhvillim të mëtutjeshëm të sistemit për sigurimin e cilësisë për AAP
11. Pako e veglave për vlerësim
12. Lista e kontrollit për vetëvlerësim
13. Pako e veglave për monitorim dhe shqyrtim
14. Pako e veglave për verifikim të brendshëm
15. Pako e veglave për përgatitjen e inspektimit

AKK ka publikuar dy (2) versione të fletëpalosjeve informative-ndërvepruese në gjuhën shqipe. Këto fletushka janë shpërndarë përmes mediumeve të shtypura të synuara, që ndërveprojnë me audiencën e përgjithshme për nivelet e KKK. Pra, çfarë niveli të KKK i takon lexuesit?

AKK po ashtu ka publikuar një fletushkë informative që përmban informata mbi rolin e AKK në raport me KKK, kualifikimet e aprovuara në KKK, ofruesit e AAP të akredituar nga AKK, si dhe përfitimet e individit, partnerëve socialë dhe ofruesve të AAP nga zbatimi i KKK. Fletushka është shpërndarë në një numër të madh të ngjarjeve dhe takimeve të ndryshme me palët e interesit.



Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara

Për të gjeneruar vetëdijesimin e publikut në përgjithësi, një fushatë me reklama televizive është zhvilluar si rezultat i projektit BE KOSVET V. Kjo ka përfshirë reklamat në kanale televizive kombëtare (shqip dhe serbisht), reklamat në radio dhe reklama në gazeta (gjysmë faqe) gjatë periudhës së fushatës (dy javët e fundit të dhjetorit). Mesazhi i AKK që është promovuar në media elektronike ka për qëllim që të ngrisë vetëdijen e njerëzve për përfitimet e kandidatëve nga procesi i zbatimit të KKK, duke krijuar mundësi të reja për t'u bërë të kualifikuar ose të ketë kualifikime të njohura për bizneset, duke siguruar se kualifikimet janë të dizajnuar për të përmbushur kërkesat e tregut të punës dhe për ofruesit, si dhe duke mbështetur zhvillimin e një tregu për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Drejtoresha e AKK ka marrë pjesë në një numër të programeve televizive dhe radiove, në të cilat është diskutuar roli i AKK, funksioni dhe objektivat e KKK, mekanizmat e zhvilluara nga KKK për zbatimin e KKK, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i KKK.

Gjatë vitit 2012 janë përcjellë aktivitet e AKK, të cilat u publikuan në mediat e shkruara dhe u paraqiten në TV nacionale dhe lokale. Artikuj të ndryshëm mbi aktivitetet e AKK u publikuan në këto mediume: Koha Ditore, Zëri, InfoPress, Kosova Sot, Exspress, Lajm, Tribuna Shqiptare dhe Epoka e re.





Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

PËRMIRËSIMI I CILËSISË
KRIJIMI I MUNDËSIVE









Ke njohuri, aftësi,
kompetencë?
Ndiqe ëndrrën tënde.

Pamje nga artikujt e publikuar në media të shkruara për KKK-në dhe AKK-në.

Zhvillimi dhe rishikimi i web-faqes

Zhvillimi dhe rishikimi i web-faqes

Me ndihmën e projektit të BE-së EU KOSVET V është zhvilluar dhe lansuar web-faqja e AKK, në tri gjuhë. Web-faqja përmban informata themelore për AKK dhe KKK, dokumente dhe publikime, të cilat janë aprovuar nga KD i AKK.

Web-faqja gjithashtu përmban materialet e publikuara për t'iu ofruar të gjitha palëve të interesuara dokumentet në format elektronike. Gjithashtu, në këtë web faqe është e publikuar edhe lista për institucionet e akreditуara. Megjithatë, web-faqja është përmirësuar për të sistemuar një sasi më të madhe të informatave dhe për të ofruar mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me web-faqet përkatëse. Në web-faqe janë vendosur edhe video dhe audio-incizimet që janë përdorë në fushatën e mediave për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara



Pamje nga konferenca e mbajtur në Bruksel e organizuar nga EQAVET rreth sigurimit të cilësisë



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

AKK synon gjithnjë në krijim dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve me rrjetet e BE-së dhe organizatave simotra në rajon dhe BE, duke marrë parasysh që një nga objektivat e KKK është lidhja e sistemit kombëtar të kualifikimeve me KEK, duke mundësuar kështu njohje dhe krahasueshmëri ndërkombëtare të kualifikimeve të Kosovës me ato të vendeve evropiane.

Sukses shumë i madh me Autoritetin e Kualifikimeve Kombëtare të Kosovës është shënuar gjatë vitit 2012, me rastin e anëtarësimit të AKK si anëtare vëzhguese në EQAVET-rrjeti evropian për sigurim të cilësisë në AAP.

Anëtarësia në EQAVET është një hap para drejt realizimit të synimeve të AKK-së; ngritjen e cilësisë në arsimin dhe trajnimin në Kosovë në përputhje me standardet evropiane.
AKK gjatë vitit 2012, ka qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve të organizuara në kuadër të procesit të Torinos mbi AAP dhe ka dhënë kontributin e vet me rastin e hartimit të raportit për Kosovën.

Në janar të vitit 2012, drejtoresha e AKK dhe eksperti i AKK për sigurim të cilësisë kanë vizituar për dy ditë Agjencinë Kombëtare për Hulumtim dhe Formësim Profesional (AKHFP) në Tiranë. Qëllimi i vizitës ishte informimi dhe konsultimi me AKHFP rreth rolit dhe procesit të vlerësimit të jashtëm, takimi me institucionet relevante për të diskutuar çështjet e aftësimit profesional në Republikën e Shqipërisë, si: vlerësimi i jashtëm, raporti i vetëvlerësimit nëpër shkolla, roli i indikatorëve (treguesve) në zhvillimin e cilësisë së aftësimit profesional, mekanizmat e sigurimit të jashtëm të cilësisë, si dhe procesin e monitorimit të jashtëm të cilësisë.



AKK me ftesën e ETF, ka marrë pjesë në punëtorinë në të cilën është diskutuar "Përkrahja për Qendrat e Kompetencës dhe Agjencisë për AAP në Kosovë", e mbajtur prej 5-8 maj 2012 në Institutin për Aftësim në Hamburg (HIBB). Gjatë kësaj vizite janë fituar njohuri edhe nga përvojat gjermane të AAP si pjesë e Kornizës së konceptit për GIZ në vendet partnere, gjithashtu janë vizituar Shkolla Profesionale nën Administrimin e HIBB dhe Qendra e Aftësimeve për Ndërtimtari dhe Qendra e Kompetencës për teknologjinë e ndërtimit. Në këtë punëtori është diskutuar edhe për Draft Propozimin për implementimin e sistemit të përkrahjes për Qendrat e Kompetencës dhe Agjencinë e AAP në Kosovë.

Në qershor 2012, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka marrë pjesë në konferencën rajonale të organizuar në Mal të Zi, që kishte si qëllim të arrihet kuptueshmëri më e mirë për rëndësinë e Kornizës së Përbashkët të Vlerësimit KPA (CAF).

AKK, me ftesë të Komisionit Evropian, nga data 1-2 tetor 2012, ka marrë pjesë në takimin e përbashkët të ECVET, EQAVET dhe EQF, mbajtur në Paris.

AKK, me ftesë të Komisionit Evropian, nga data 18-19 tetor 2012, ka marrë pjesë në Romë, në punëtorinë e Mësimit të ndërsjellë me përfaqësuesit e vendeve anëtare të BE-së. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të: përkrahet promovimi i rekomandimeve të ECVET në vendet anëtare të BE-së; ndajë dhe këmbejë ekspertizat nga zbatimi i ECVET; ndajë, zhvillojë dhe adaptojë metodat për të përkrahur zbatimin, zhvillimin e procesit të cilësisë me përfshirjen e palëve me interes, ndërtimin e rrjetit të grupit përdoruesve të ECVET; kontribuojë në procesin evropian për ECVET.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve nga data 15-16 nëntor 2012, ka marrë pjesë në takimin e rrjetit të EQAVET në Bruksel, të organizuar nga Drejtorati i përgjithshëm për Arsim dhe Kulturë i Komisionit Evropian. Në këtë takim të pranishmit janë njoftuar për studimin e CEDEFOP, që ka të bëjë me qasjen e menaxhimit të brendshëm të cilësisë së ofruesve të AAP, janë diskutuar të arriturat kombëtare në pikat e reja të referimit për EQAVET dhe për studimin e fundit të sekretariatit të EQAVET, bazuar në raportet kombëtare, pastaj për studimin e vlerësimit të jashtëm EQAVET, projektet e EQAVET për vitin 2013. Gjithashtu, në kuadër të këtij takimi, është organizuar edhe një punëtori e përbashkët ECVET, EQF, Arsimi i lartë, Sigurimi i Cilësisë dhe Arsimi i të rriturve. Po ashtu, ka arritur ftesa për përfaqësuesit e AKK në konferencën që është paraparë të mbahet nga 17-18 janar 2012 në Bruksel, me temën "Sigurimi i cilësisë në praktikat e AAP dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i EQAVET në nivel kombëtar".



Pamje nga takimi me përfaqësuesin e Silvo Sud nga Italia

AKK si pjesë e një delegacioni të gjerë nga Kosova, nga 20-21 nëntor ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale të Ballkanit Perëndimor, me temën " Si do të mbetet Arsimi i Lartë relevant ndaj ndryshimeve globale?". Në këtë konferencë janë diskutuar çështjet siç janë: Arsimi i Lartë në shoqërinë që ndryshon, shkathtësi e jo vetëm diploma, punësueshmëria e të diplomuarve dhe relevanca e Arsimit të Lartë, Kornizat e Kualifikimeve dhe Njohja etj.

Ekspertët për sigurim të cilësisë së AKK, më 3 dhjetor 2012, kanë marrë pjesë në takimin e katërt dhe të fundit të rrjetit të cilësisë "VET-CERT" në Vjenë të Austrisë, me temën "Kualifikimi si formë e cilësisë" sipas pikave të referimit kombëtar.
Konkluzionet e dala nga ky takim ishin: promovimi i Kurrikulës së re dhe moduleve për sigurim të cilësisë, si dhe punëtoria e organizuar për grupin ndërkombëtar me qëllim të transferimit të rezultateve të AAP-CERT në kontekste të tjera kombëtare, gjithashtu dhe analizimi i moduleve në kontekstin kombëtar nga përfaqësuesit që ishin prezent në këtë grup punues.

AKK, me datën 6 dhjetor 2012, ka marrë pjesë në Seminarin Ndërkombëtar për Njohjen e Mësimit Paraprak (NJMP) në Zagreb, me ftesë së Ministrisë së Shkencës, Arsimit dhe Sporteve dhe Institutit për Zhvillimin e Arsimit. Qëllimi i takimit ishte të prezantohen konkluzionet e projektit për NJMP- "Urat lidhëse ndërmjet Arsimit të Lartë dhe Arsimit profesional", njohja me praktikat e disa vendeve evropiane për NJMP dhe që të diskutohen disa nga çështjet kritike të zbatimit të NJMP. Gjithashtu, ekspertë nga Franca, Skocia, Polonia dhe Kroacia kanë paraqitur pikëpamjet e tyre sa i përket NJMP.

Në kuadër të aktiviteteve të jashtme, në dhjetor të këtij viti, AKK ka qenë pjesëmarrëse në Këshillin Drejtues të Akademisë Rajonale Andragogjike në Vjenë të Austrisë, i cili takim është mundësuar nga DVV internacional me përfaqësi në Prishtinë. Në këtë takim u diskutua kursi i takimeve të ardhshme të ARA dhe zhvillimi i kurrikulës globale për kualifikimin e andragogut.
Më datat 13-14 dhjetor, AKK po ashtu ka qenë pjesëmarrëse në konferencën për Njohjen e Mësimit Paraprak (NJMP) në arsimin e lartë profesional, e mbajtur në Pragë të Çekisë dhe e organizuar nga EURASHE, Rrjeti Evropian i NJMP si dhe Ministria çeke e Arsimit. Tematikë kryesore e konferencës ishte "NJMP, lidhjet fleksibile brenda Arsimit të Lartë". Kjo konference ofroi një pasqyrë të zhvillimeve të përgjithshme të NJMP, me mundësi për të diskutuar sfidat aktuale dhe të mësojnë nga shembujt e praktikave më të mira sa i përket zbatimit të NJMP në nivel institucional.

Punëtori për sigurim të cilësisë e përkrahur nga ETF



Gjithashtu, AKK ka punuar në zhvillimin e bashkëpunimit me të gjitha palët me interes në fushën e AAP dhe partneritetit me donatorët e ndryshëm edhe brenda vendit. Gjatë tërë vitit , Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka zhvilluar shumë takime me donatorët e ndryshëm në Kosovë, siç janë: GIZ, LuxDevelopment, Këshillin Britanik, Bankën Botërore, Swisscontact, DVV, në të cilat takime janë diskutuar tema të ndryshme që kryesisht kishin të bëjnë me:

- elaborimin e mundësive dhe planeve për mbështetje nga donatorët të aktiviteteve të AKK që lidhen me zbatimin e KKK dhe ngritjen e cilësisë;
- mbështetjen dhe koordinimin e aktiviteteve të donatorëve nga ana e AKK;
- takime të rregullta informative me donatorët përsa i përket të arriturave dhe sfidave në aktivitetet e AKK të financuara nga ta dhe planet vijuese;
- diskutimet rreth harmonizimit të dokumenteve të propozuara nga GIZ për Raportin e Vetëvlerësimit me dokumentet e krijuara nga AKK për Qendrat e Kompetencës;
- Zhvillimi i fisheve të projekteve për Programimi i IPA 2012, etj.



Në kuadër të realizimit të Planit të punës për vitin 2012, rëndësi e madhe i është dhënë ngritjes së kapaciteteve të veta, përmes pjesëmarrjes aktive në të gjitha zhvillimet në fushën e AAP-së në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Në maj 2012, AKK ishte pjesëmarrëse në trajnimin për Sigurim të Cilësisë, me pjesëmarrës nga Kosova, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbia, organizuar nga DVV International. Çështjet e trajtuara në këtë trajnim ishin; indikatorët kyç, standardet dhe kriteret e cilësisë, qasja në TQM, Kornizat e BE-së për cilësinë e Institucioneve dhe për Arsimin e të rriturve, Institucionet e Evropës Juglindore dhe standardet evropiane, rëndësia e themelimit të sistemit të cilësisë në arsimimin e të rriturve, esenca dhe karakteristikat e modeleve të ndryshme të sistemit të sigurimit të cilësisë dhe menaxhimit në institucionet për arsimin e të rriturve.



Pamje nga konferenca për NJMP Pragë, Çeki



Shënim

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Adresa:
Qendra e Studentëve
Rr. Agim Ramadani p.n
Prishtina 10000
Republika e Kosovës
Tel: +381 (0)38 212-595
Fax: +381 (0)38 213 433

Për me shume vizitojeni faqen:
www.akk-ks.net